


Si të shmangen gabimet më të mëdha financiare që bëjnë gratë



Gabimi i Evës është një ndër gabimet më të zakonshme që bëjnë gratë. Shumë gra e marrin të mirëqenë se burrat i kuptojnë çështjet financiare më mirë se ato vetë, kështu që ua lënë qesen e shtëpisë atyre. Zgjidhja për këtë? Një kurs për menaxhimin e parave ose investimet, leximi i librave mbi këtë temë ose pjesëmarrja në seminare e trainime mbi këtë temë. Mbi të gjitha, jini partnere në menaxhimin e parave në familjen tuaj. Mbani llogari të përbashkët me burrin dhe në fund të çdo muaji bëni bilancin familjar të financave së bashku.

Jo të gjitha gabimet me paratë kanë zgjidhje të drejtpërdrejta. Prapëse-prapë, gafat financiare e kanë një rrugë-dalje. Por puna është që në fillim duhet të dihet se cilat janë këto gabime që bëhen shpesh.

Gabimi # 1

Të menduarit se ti nuk merr aq para, sa të kursesh ndonjë gjë. Vetëm po të jetosh në nivelin e varfërisë, nuk do të kesh ndonjë gjë për të kursyer.

Rregulloje këtë gabim! Mbay shënim të gjitha të ardhurat që ke, dhe të gjitha shpenzimet që bën në baza mujore. Në këtë mënyrë ti do të dish sa para merr në muaj dhe ku i harxhon paratë që merr. Pastaj kërko ndonjë mënyrë se si mund të kursesh, si fillim të paktën 100 Lekë në ditë. Pas afro tre muajsh, do të kesh kursyer afro 10 000 Lekë të cilat mund t'i depozitosh në një llogari në bankën tënde e të marrësh interes. Nëse e vazhdoni kursimin për çdo ditë, në fund të vitit do të keni afro 35 000 Lekë në depozitën tuaj, përveç interesit që do të ketë ardhur me to.

Gabimi # 2

Ke një qëllim financiar, por asnjë plan për realizimin e tij. Në ato raste kur doni të humbni kilet e tepërta, ju nuk


rrini vetëm duke ëndërruar, por ndiqni një plan diete ose shkoni në palestër, pra veproni për realizimin e tij. Në të njëjtën mënyrë, nëse doni të kurseni një sasi parash deri në moshën 65 vjeçare, juve ju duhet të ndiqni një plan për realizimin e tij.

Rregullojeni këtë gabim! Nëse nuk e bëni dot vetë një plan për menaxhimin e financave tuaja, atëherë do të ishte mirë të kërkonit ndihmë prej ndonjë të afërmi apo miqve tuaj, të cilët ju i respektoni për mendjemprehtësinë e tyre financiare. Ndoshta këtë ndihmë mund ta gjeni në libra të posaçëm ose në faqe të ndryshme të internetit gjithashtu.

Gabimi # 3

Të menduarit se tani është tepër vonë për të filluar të kursesh. Nuk ka rëndësi moshja për të filluar kursimin e parave. E vetmja kohë kur është tepër vonë, është kur të kesh shkuar në botën tjetër.

Rregullojeni këtë gabim! Filloni të kurseni para që në këtë moment. Do ishte mirë të hapnit një llogari rrjedhëse dhe që në ditën kur merrni rrogën, lini në llogarinë tuaj një sasi parash sipas mundësive tuaja. Mos i prekni këto para gjatë muajit. Shumë shpejt do ta shihni se në fuund të vitit do të keni ca para mënjane.



Eva, një nënë me katër fëmijë, ishte e okupuar me rritjen e tyre. Ajo nuk punonte; me financat e familjes merrej bashkëshorti i vet. "Gabim i madh," thotë tani Eva, e cila sot është e ndarë nga burri dhe po punon tërë ditën për të larë borxhet që i ishin mbledhur ndërkohë që ishte e martuar. "Duhej të isha përfshirë më tepër me paratë e familjes që të dija se ku po shkonin ato." Por asaj iu desh të mësonte për menaxhimin e parave nën rrethana të tmerrshme.

Gabimi # 4

Dhënia hua e parave të afërmve ose miqve. Nuk është e pazakonshme që një person të marrë para borxh prej një të afërmi ose një miku e të mos jetë në gjendje t'ua kthejë borxhin.

Rregullojeni këtë gabim! Jepni para hua vetëm në ato raste kur mund të jeni të përgatitur që ato para ndoshta mund t'ju duhet t'i jepni si dhuratë. Juve ndoshta mund të shpresoni se do t'ju kthehen paratë me këste, por ndodh që prej njerëzve brenda rrethit shoqëror e familjar paratë mund edhe të mos ketë mundësi t'ju kthehen fare.

Gabimi # 5

Shpenzimi tej mase i parave me fëmijët për shkak të ndjenjës së fajit ndaj tyre.

Është e lehtë të jepesh pas punës e të lesh pas dore fëmijët e tu. Kjo të çon në ndjenjën e fajit e cila të shtyn të kompensosh duke harxhuar para për fëmijët në aktivitete të ndryshme ose në blerje lodrash e gjërash argëtuese.

Rregullojeni këtë gabim! Nëse e gjeni veten të kapur në këtë kurth, atëherë është koha të rishikoni e rivlerësoni prioritetet tuaja. Vërtet mendoni se fëmijët tuaj do të mendojnë se ju jeni një prind më i mirë për shkak se u blini atyre shumë lodra? Vallë vërtet e kërkonti këtë të jetë modeli juaj i përgjegjshmërisë financiare për ta? Përpara se t'i përgjigjeni kësaj pyetjeje pozitivisht, provoni këtë: Kaloni kohë me fëmijët tuaj në vend që të harxhoni para. Ajo që u jepni me prezencën tuaj është më e çmuar se çdo send apo gjë tjetër.

Gabimi # 6

Mendimi se ju nuk jeni i autorizuar të hyni në bisedime me kreditorët tuaj. Shumë gra e marrin të mirëqenë se të gjitha faturat duhet të paguhen plotësisht sapo mbërrijnë në shtëpi, gjë që do të thotë se kursimet e tyre mund të harxhohen pothuajse menjëherë, ose karta e kreditit mund të ngarkohet me një borxh të madh.

Rregullojeni këtë gabim! Pas divorcit, Eva e pa veten të rrethuar nga fatura të mëdha, të cilat nuk mund t'i paguante dot njëherësh. "I kërkova dentistit nëse mund të paguaja me këste," tha ajo. Ai ra dakord. "Gjithashtu bisedova me

menaxherin e bankës ku kisha marrë kredinë për shtëpinë që pagesat mujore të uleshin pak. Ai ra dakord, gjithashtu." Bizneset, bankat, mjekët, etj, duan që t'u bëhen pagesat, ata janë të gatshëm të hyjnë në bisedime e nuk preferojnë të luftojnë për paratë."

Gabimi # 7

Marrja e kredive konsumatore – vetëm sa për t'u futur akoma më shumë në borxhe. Shumë njerëz jetojnë një lloj jete përtej mundësive reale të tyre.

Rregullojeni këtë gabim! Herën tjetër që do të tundoheshit ta blinit me kredi konsumatore diçka që është përtej mundësive tuaja financiare bëni këtë eksperiment: Llogariteni me anë të bankës ku keni ndërmend për të marrë kredinë se sa do të jetë pagesa juaj mujore. Para se ta merrni kredinë, për disa muaj lini mënjatë atë sasi parash në llogarinë tuaj bankare dhe shihni se si do t'ia dilni financiarisht çdo muaj pa atë sasi parash. Po qe se do ta prekni këtë llogari për të mbuluar shpenzimet tuaja, kjo është një shenjë se nuk duhet të merrni një kredi të tillë. Ju do të kishit hyrë në një borxh që nuk do të ishit në gjendje ta shlyenit.

Gabimi # 8

Pagesat vjetore e taksat e anëtarësimit për shërbime që ju nuk i përdorni më. Mira ishte regjistruar si anëtare e një bibliotekë private, por ajo shkoi atje vetëm dy herë tërë vitin. Po ashtu ishte regjistruar në një palestër për të shkuar tre herë në javë nga dy orë, kur në të vërtetë shkonte vetëm tre herë në muaj për shkak të punës. Megjithatë ajo kishte bërë pagesën vjetore plus taksën e anëtarësimit. Si Mira ka plot gra e vajza që nga entuziazmi për të realizuar diçka nxitohen për t'i paguar paratë për shërbime që nuk mund t'i përdorin dot për shkak të mungesës së kohës.

Rregullojeni këtë gabim! Kur bëni pagesat e anëtarësimit vjetor në klube, palestra, kurse të ndryshme, biblioteka, ambulanca etj, shikoni nëse është më mirë për ju të paguani taksën e anëtarësisë, apo të paguani sipas shërbimit kur të keni nevojë. Mos i bëni këto pagesa automatikisht nga llogaria juaj bankare. Ka shumë të ngjarë që paratë t'ju mbahen automatikisht vit pas viti edhe pse ju mund të keni harruar. Shikoni mundësitë që një pjesë të

shërbimeve t'i realizoni në shtëpi. Psh. blini një pajisje force dhe kështu e keni palestrën në shtëpi.

Gabimi # 9

Shpenzimi i parave që të ndihesh më mirë për vete. Mjaft njerëz harxhojnë para që të përmirësojnë imazhin për veten, një pjesë harxhojnë para për të larguar stresin dhe një pjesë tjetër për jetojnë ndryshim të gjendjes emocionale pikërisht në momentin e harxhimit të parave.

Rregullojeni këtë gabim! Për ata që kërkojnë të ndihen më mirë emocionalisht ose të largojnë stresin, ka rrugëzgjidhje tjetër. Sporti, muzika, artet e ndryshme, shëtitjet në park ose kalimi i kohës me njerëz të dashur e luajnë shumë mirë rolin për të dhënë një gjendje të mirë emocionale e për të larguar stresin. Mos u gënjeni nga ideja se sa më shumë para të harxhoni, aq më mirë do të ndiheni. Ka mjaft të ngjarë që do të keni telashe të mëdha financiare po të vazhdoni me këtë metodë lehtësimi të stresit për një kohë të gjatë.

Gabimi # 10

Të mos paturit e një plani për pakësimin e borxheve. Të zë dhimbja e kokës kur sasia e parave që ke marrë borxh është shumë më e madhe nga ajo që fiton në vit. Dhimbja shtohet kur ke marrë disa kredi konsumatore dhe disa hua prej të afërmve. Por problemi keqësohet kur nuk ke bërë asnjë plan për të pakësuar borxhet.

Rregullojeni këtë gabim! Shkruajini të gjitha borxhet duke i renditur sipas sasisë së tyre, përfshirë edhe interesin [kur borxhet i keni marë me interes]. Bëni vetëm pagesat minimale mujore për të larë borxhet e vendeve të fundit në listën tuaj, dhe pjesën tjetër të parave përdoreni për të reduktuar borxhet e mëdha që i keni në fillim të listës. Kërkonti ndihmë prej konsulentëve financiarë për të kaluar prej kredive me interes të lartë në hua me interes të ulët, me qëllim që pas disa muajsh / vitesh të mos keni para borxh.

Gratë nuk ka pse të ndihen më pak të zonjat në menaxhimin e parave. Gjithçka duhet është pak vëmendje, studim për menaxhimin e financave personale dhe pak llogaritje. Nuk i kanë thënë kot "Jeta është matematikë ...!"

Rëndësia e një buxheti për shpenzimet

Ne vazave dhe grave na pëlqejnë aq shumë blerjet, sa që nuk është çudi të hyjmë në dyqane me portofolin plot dhe të dalim pa asgjë në të. Megjithatë nuk jemi vetëm ne femrat që kemi një marrëdhënie të tillë me paratë, edhe gjinia tjetër nuk ngelet pas, sidomos studentët dhe të pamartuarit.

Por shpenzimi i paplanifikuar shpesh të çon në një lësh financiar. Buxheti, ose ndryshe një "plan shpenzimi", është një mënyrë për të planifikuar shpenzimin e çdo kartëmonedhe. Plani i shpenzimeve na tregon se ku jemi dhe si mund të arrijmë atje ku duam. Një mënyrë e mirë shpenzimi është të dimë se çdo kartëmonedhë do të përdoret për diçka specifike. Kjo do të jetë një hartë financiare e leverdishme për të mbrojtur financat tona.

Hapat bazë të krijimit të një buxheti (të një plani shpenzimi) janë:

1. Plani i shkruar

Përdorni një plan të shkruar të të gjitha shpenzimeve dhe renditini për nga rëndësia. Sot njerëzit e kanë humbur orientimin midis nevojave dhe dëshirave. Nevojat janë blerjet për të siguruar kërkesat themelore, si: ushqim, veshje, qira shtëpie, vizita mjekësore etj. Dëshirat janë zgjedhje të cilat mund të bëhet vetëm nga fondet e tepërta, pasi janë përmbushur të gjitha detyrimet e tjera. Mbjaj shënim sa para fiton. Fillo me gjërat kryesore, siç janë: e dhjeta (e dhjeta i jepet Perëndisë si një dëshmi që gjithçka që kemi vjen nga Ai (Marku 12:41-44; Malakia 3:8-12), qiraja, pagesa e makinës, faturat e energjisë dhe ujit etj.

2. Rendit shpenzimet thelbësore, jo të rregullta

Shuma e këtyre faturave ndryshon

nga njëri muaj në tjetrin. Ndër këto përfshihen: telefoni, ushqimi, shpenzime për rregullimin e pajisjeve që prishen, karburanti i makinës, ilaçet, transporti publik, veshje dhe këpucë. Ti mund të vendosësh një shumë të caktuar parash, bazuar në përvojat e mëparshme, duke e rrumbullakosur gjithmonë shumën. Rendit shumën të arsyeshme për shpenzime të tjera, si argëtimi, darkat jashtë, palestra etj.

3. Gjej shtesat.

Hap planin e muajit të kaluar për të kontrolluar çfarë shpenzimesh ke lënë jashtë. Me shumë mundësi atje do shohësh gjëra, si: dhuratat, pushimet verore, mirëmbajtja dhe riparimi i makinës etj. Përcakto një kosto vjetore, më pas ndaje këtë shumë në dymbëdhjetë pjesë, shumë që duhet ta heqësh mënjatë çdo muaj nëse do të bësh pushime kur të vijë koha, përndryshe do të mbetesh pa pushime.

4. Llogarit totalët.

Nëse shpenzimet e tua ia kalojnë të ardhurave, do të shohësh se shifra jote del me minus. Mos u shkurajo; ky është fillimi i një procesi të gjatë.

5. Redukto.

Nëse del me minus, atëherë ktheju edhe një herë shpenzimeve mujore dhe shiko se çfarë mund të heqësh. Fillo me shpenzimet jo të domosdoshme. Hiq aq shpenzime, sa ndërsa bën balancin, shpenzimet të jenë më të ulëta sesa të ardhurat. Bëj pyetjen: "A është kjo

një domosdoshmëri? A e pasqyron kjo blerje etikën time si i/e krishterë? P.sh. Zbavitja është një domosdoshmëri e mirë nëse vihet në perspektivën e duhur, por ata që janë në borxh nuk mund të përdorin paratë e të tjerëve për t'u argëtuar.

6. Kurse.

Kursimi i parave rregullisht është shumë i rëndësishëm. Të gjithë ata që jetojnë mbi nivelin e varfërisë kanë aftësi të kursejnë, por shumë nuk arrijnë ta bëjnë, sepse besojnë se shumica është aq e vogël, sa që nuk ia vlen. Edhe në qoftë se ajo është vetëm 500 lekë në muaj, kjo do të zhvillojë një disiplinë kursimi (Fjalët e Urta 21:20).

7. Ndiq planin e shpenzimeve

Kontrollo shpenzimet çdo ditë. Mbjaj shënime dhe gjej mënyra si të bësh një buxhet më të mirë për muajin tjetër. Në fund të muajit, kontrollo shpenzimet aktuale me ato të planifikuarat. Këtë informacion përdore për të bërë planin e shpenzimit të ardhshëm mujor. Edhe sikur të ndihesh pak ngushtë financiarisht këto kohë, merr zemër. Ndërkohë që shlyen borxhet dhe gjen mënyrat për të shkurtuar shpenzimet, do të fillosh të ndiesh një çlirim prej presionit financiar. Sa më herët ta fillosh bërjen e një buxheti, aq më shpejt do të shijosh kënaqësinë e lirisë financiare. Të jetosh me një buxhet nuk është vetëm maturi, por mund të jetë edhe kënaqësi.

Përgatiti Afërdita Dundo